

FJALA E DEPUTETIT RAMADAN LIKAJ

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

U bënë dy javë që po vardiset ky projektligj, ose marrëveshje, siç e quani ju, me një nxitim të jashtëzakonshëm. Neve, si opozitarë, por edhe çdo qytetari shqiptar i ka bërë përshtypje se çfarë është ky nxitim për një ligj të tillë, që grabitë një pjesë të madhe të pasurisë kombëtare dhe në mënyrë të veçantë portin e Durrësit. Unë dua ta filloj fjalë time si biznesmen.

Shumë kolegë të maxhorancës thanë që në krahun tjetër ka biznesmenë të mirë, të frytshëm, të suksesshëm, por që nuk ndajnë të njëjtin mendim me një pjesës tjetër të opozitës. Absolutisht po, sepse në një marrëveshje të tillë, për një biznesmen kaq të fuqishëm, unë e respektoj çdo biznesmen në çdo vend të botës dhe në mënyrë të veçantë ata që vijnë në Shqipëri, thuhet se ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur. Unë jam dakord me këtë, por, si biznesmen, mendoj se, në qoftë se për një marrëveshje të tillë duhet të paraqesësh të gjithë dokumentacionin përkatës, duhet të kesh edhe kolateral, sepse nuk ka marrëveshje dhe as as bankë në botë që të afrohet po nuk pate një kolateral.

Jam dakord që ky investim, me 2,1 miliardë, i cili ka dy javë që trumbetohet me forcë nga qeveria, është investimi më i madh, por mendoj se ky investim, në një kohë të tillë që po kalojmë, nuk është për interesa të shqiptarëve. Mes të tjerave, në këtë marrëveshje thuhet se do të punësohen 12 mijë punonjës. Sigurisht që kjo nuk është e vërtetë, sepse 12 mijë punonjës sot nuk ke ku t'i gjesh, pasi gjetja e tyre është problem në vete. Shoh më poshtë që në këtë projekt do të ndërtohet një ndër hotelet më të bukura me 5 yje, me rreth 850 dhoma, por kam bindjen se pas një afere kaq të madhe fshihet një pjesë e madhe e investitorëve që kemi rrotull nëpër kulla, të cilët do të dalin më vonë.

Në një vend tjetër thuhet që shteti shqiptar është 33% aksioner, por kush pyet për ju, kur ju nuk keni një maxhorancë për të vepruar nesër me 33%, sepse në një biznes për çdolloj marrëveshjeje duhet të kapësh 50 plus 1 për të krijuar bindjen tek të tjerët. Në një vend tjetër thuhet që në këtë marrëveshje do të ketë të ardhura shteti shqiptar, ku përmendet për 20 vjet. Pyetja ime është shumë e thjeshtë: në qoftë se ka një planbiznesi të tillë, që duhet ta kuptojë çdo shqiptar sot, ku është ky plan-biznes, sepse

ne duhet t'u themi qytetarëve shqiptarë se të ardhurat nga ky investim do të jenë këto dhe që shteti shqiptar do të përfitojë këto të ardhura për kaç vite. Në një pjesë tjetër të marrëveshjes thuhet që shteti do të përfitojë të ardhura nga dividenti.

Nga cili dividend do të përfitojë, kur një biznes nuk e ka filluar ende aktivitetin e tij dhe nuk ka një bilanc?! Për mendimin tim dhe për mendimin e çdo shqiptari nga këto veprime shihet qartë që fshihet diçka shumë e madhe. Kryeministri trumbetoi me të madhe, madje ulëriti, për një investim kaç të madh, që, në fakt u përket kaç pak njerëzve. Kjo është bindja ime, është dyshim dhe shpresoj që ky dyshim të jetë i kundërt nesër dhe të përfitojnë, ashtu siç ju thoni, qytetarët shqiptarë. Në krahun tjetër, kemi përmbytje të përditshme në qarkun e Shkodrës dhe në zonën e Malësisë së Madhe. Ne vazhdojmë e bëjmë politikë për interesat e disa personave dhe nuk merremi drejtpërdrejt me problemet dhe hallet e qytetarëve.

Para tri ditësh shkova në një fshat të Malësisë së Madhe, që quhet Përroi i Thatë, unë e kam hedhur edhe në rrjetet e mia sociale, ku ishte ndarë fshati përgjysmë. Ka 30 vjet që kërkohet në mënyrë intensive të bëhet një urë dhe ai të lidhet fshat, fshati Kamicë, por vazhdon e njëjta situatë. Unë e di shumë mirë se qytetarët të asaj zone e vuajnë këtë gjë dhe kishte edhe nga ata qytetarë, të cilët i përgëzoj për ato që ata shprehën, dhe më thanë që ti ke qenë kryetar i bashkisë pse nuk e ke bërë urën?! Unë nuk u ktheva përgjigje: “Kur unë isha kryetar i bashkisë së Koplikut, kishte edhe 5 komuna përreth, ndërsa sot, pas ndarjes së re territoriale në vitin 2015, është vetëm bashkia e Malësisë së Madhe”.

Gjithësesi, unë kam të drejtën morale dhe njerëzore, edhe si politikan, por edhe si përfaqësues i asaj zone, t'i bëj thirrje kësaj qeverie dhe në mënyrë të veçantë ministres Spiropali, zonja Ministre, mund të shkojmë bashkë kur të duash e të shohim si është i ndarë përgjysmë fshati, që të bëjnë një urë, për të cilën flitet prej 32 vjetësh. Dua të sqaroj edhe dy gjëra të tjera. Sot opozita shqiptare po luftohet fuqishëm, po na shani pa fund, ditë e natë: “Merruni me ata, mos u merrni me ata”.

Të nderuar kolegë, mos është më mirë të merreni me diçka tjetër që ndihmon me qytetarët dhe jo të merreni me ne? Mendoni se duke u marrë me ne do të mbyllni çdo lloj problemi që keni brenda jush?! Ne nuk po shajmë njeri dhe nuk po fyejmë njeri, ndërsa ju po shani, po fyesi e po hidhni baltë çdo minutë e çdo sekondë mbi ne. Çfarë problemesh kam unë që shani e fyesi çdo ditë? Çfarë detyrimi kam ndaj kësaj maxhorance, kur unë respektoj çdo ligj në këtë vend dhe nuk merrem me asnjë lloj afere, përkundrazi, jam marrë e vazhdojmë të merrem me punë të ndershme dhe të pastra për 30 vjet në këtë

vend? Për ta mbyllur fjalën time dua t'ju them se, në qoftë se ju e vazhdoni kështu, mendoj se e ardhmja juaj nuk ka për të qenë e gjatë. Pse? Sepse sado që t'ju duket juve se opozita shqiptare ka probleme, do të vijë një moment që do të bashkohemi.

Në vitin 2013, kur ne ishim në pushtet, një pjesë thoshte që kur po vjen koha të ikni, ndërsa juve ju ka ardhur koha të ikni jo sot, por ka, të paktën, 5 vjet. Ju vazhdoni të qeverisni në mënyrën më arrogante se kushdo tjetër. Sot po ikin shumë shqiptarë nga ky vend, por ju në asnjë moment nuk po ngrini zërin dhe nuk pyesni, përkundrazi, merreni vetëm me investime dhe biznese derisa të çoni në zero gjithçka. Kjo është puna juaj, ky është interesi juaj, por të jeni të bindur se shqiptarët një ditë do të dinë t'i pasqyrojnë këto gjëra. Nuk keni për ta pasur të gjatë, sepse çdo gjë do të dalë në dritë të diellit. Faleminderit!